



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 16 nëntor 2022
Kodi i ZRRE-së V_ 1619_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e neneve 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
- Dispozitën e Nenit 16, paragrafi 1.41 i ligjit për Energjinë Elektrike,
- Nenin 16 të Licencës së Operatorit të sistemit të transmetimit, dhe
- Nenin 7.1.1 të Rregullave të tregut,
- Kërkesën e KOSTT të datës 17.10.2022 për aprovimin e dokumenteve: Rregullat e harmonizuara të alokimit të të Drejtave Afatgjate të Transmisionit, Rregullat për Alokimin Eksplícit Ditor të Kapacitetit në kufijtë e Zonave Ofertuese të shërbyer nga Zyra e Ankandëve të Koordinuara të Evropës Juglindore (SEE CAO) Versioni 2.0, dhe Shtojcë e veçantë për kufijtë e zonës së ofertimit të shërbyer nga SEE CAO e Rregullave të harmonizuara të alokimit për të drejtat afatgjate të transmisionit.

në seancën e mbajtur me 16 nëntor 2022, nxori këtë:

V E N D I M

I Aprovohet dokumentet:

- o *Rregullat e harmonizuara të alokimit të të Drejtave Afatgjate të Transmisionit,*
- o *Rregullat për Alokimin Eksplícit Ditor të Kapacitetit në kufijtë e Zonave Ofertuese të shërbyer nga Zyra e Ankandëve të Koordinuara të Evropës Juglindore (SEE CAO) Versioni 2.0,*
- o *Shtojcë e veçantë për kufijtë e zonës së ofertimit të shërbyer nga SEE CAO e Rregullave të harmonizuara të alokimit për të drejtat afatgjate të transmisionit.*

Arsyetim

KOSTT është aksionar në Zyrën e Ankandëve të Koordinuara në Evropën Juglindore (SEE CAO), prandaj obligohet që ndryshimet në legjislacionin përkatës të kërkoj përmes kërkesave për miratim në ZRRE. Në këtë kuadër, Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 17.10.2022 ka pranuar kërkesën e KOSTT për miratimin e ndryshimeve të Rregullave: *Rregullat e harmonizuara të alokimit të të Drejtave Afatgjate të Transmisionit; Rregullat për Alokimin Eksplícit Ditor të Kapacitetit në kufijtë e Zonave Ofertuese të shërbyer nga Zyra e Ankandëve të Koordinuara në Evropën Jug-Lindore (SEE CAO) Versioni 2.0; dhe Shtojcë e veçantë*

për kufijtë e zonës së ofertimit të shërbyer nga SEE CAO e Rregullave të harmonizuara të alokimit për të drejtat afatgjata të transmisionit.

Fillimisht, këto Rregulla janë miratuar nga ZRRE me datë 12 mars 2014, dhe pastaj është miratuar amendamenti i tyre me 03 tetor 2016, dhe të njëjtat janë amendimetuar edhe me 12 nëntor 2020.

Ky amendamentim fillimisht është miratuar në datën 3 Qershor 2022, nga Bordi Drejtues i SEE CAO, dhe këto Rregulla i janë nënshtruar konsultimit publik të organizuar nga SEE CAO, si dhe KOSTT, gjatë të cilit çdo palë e interesi ka pasur mundësinë të japë komentet apo sugjerimet përkatëse.

ZRRE pas shqyrtimit të dokumenteve, si dhe rrethanave aktuale për kryerjen e aktivitetit të ankandit për alokimin e kapaciteteve, ka miratuar dokumentet sipas kërkesës së KOSTT me nr. 2094 të datës 17.10.2022 për Përditësimin e Rregullave të Ankandit për Alokimin e Kapaciteteve në Zyrën e Ankandit të Koordinuar në Evropën Jug-Lindore.

Hyrja në fuqi e këtyre dokumenteve shfuqizon versionin paraprak të tyre të aprovuar nga Bordi i ZRRE-së me datë 12.11.2020.

II. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:



Ymer Fejzullahu, Kryesues



Selman Hati, anëtar



Izet Rushiti, anëtar



Lutfije Dervishi, anëtar



Ganj Buçaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Arkivit të ZRRE-së.